



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-14073/25 datë:18.06.2025



Npi – 01/224 datë: 25.06.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.06.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë -VI- T Ë K O M I T E T I T P Ë R P O L I T I K Ë D H E F I N A N C A

E mbajtur më datën: 25.06.2025 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Besnik Ahmeti, DBF: Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe z.Albion Shabani.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.05.2025,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës. Sot besoj që do të jetë mbledhja pak më e shkurtë pasi që do të jenë vetëm dy pika të rendit të ditës. Materialin e keni marrë, është ardhur pak me vonesë për shkak të dëgjimeve publike që kanë qenë duke u mbajtur, dhe me qëllim që të gjitha kërkesat e qytetarëve me i fuzionuar në Kornizë edhe besoj që dje ka ardhur ftesa se unë s'kam mundur me hap as E-mailin.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Fillimisht, kolegut Muhamet Ademaj i dëshiroj mirëseardhje në KPF. Kryesues pajtohem me propozimin e juaj për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.05.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.05.2025.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Më lejoni të ju njoftoj se kjo Draft-Kornizë ka rrjedhë si rezultat i diskutimeve publike në të gjitha vendbanimet e Komunës së Shitimes, dhe në përfundim buxheti prej 11 milion e 443 mijë euro është buxhet që ka ardhur përmes vetfinancimit, granti i përgjithshëm (shih dokumentin) granti për arsim (shih dokoumentin) granti për shëndetsi,

shërbimet dhe të hyrat vetanake (shih dokumentin). Pas diskutimeve publike në të gjitha fshatrat e Komunës së Shtimes, Drejtoria e Financave në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë janë ardhur në përfundim që Buxheti të ndahet në katër kategori ekonomike: Paga dhe Mëditje etj. (shih dokumentin). Sa i përket numrit të stafit për vitin 2026 është 748. Ndërsa për 10 është numri më i madh këtë vit për shkak të disa politikave të reja. 6 janë staf që kanë me u destinuar te Çerdhja në fshatin Petrovë, ndërsa 4 në shëndetësi, janë për mjekësinë primare, është një psikolog, një fizioterapeut një logoped edhe një punëtor social. Kjo është një politikë e re nëpër gjitha komunat e Kosovës, faktikisht 192 pozita të reja ku komuna jonë i ka 4 pozita. Marrë për bazë dëgjimet publike duhet me i shiquar cilat projekte janë duke vazhduar ose janë të buxhetume, më herët dmth. me konrnizën e më hershme buxhetore. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Drejtor një pyetje, kufijt ekonomik a i keni mborjtur tash, apo keni me shku me i mbrojtur?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ky material dërgohet me 30 Qershor 2025 në Ministrinë e Financave, është koha që kemi me i mbrojtur kufijt ekonomik, pastaj nëpër nënprograme nëpër drejtorori mundemi me bërë lëvizje, mirëpo këta janë kufijtë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Sa për sçarime kjo do të thotë që në muajin Gusht shkon edhe një herë në diskutim public, pasi që të mbrohen kufijtë te Thesari i Shtetit.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit drejtor për sçarimet. Kryesues e dime të gjithë që materialin e kemi marrë pak me vonesë edhe po besoj që është një dokument më i rëndësishëm i Komunës për miratim, këtu besoj që krejt prej asambleistëve duhet me qenë të kujdesshëm sepse jemi duke diskutuar për shpenzimet për vitin 2026. Këtu në këtë moment nuk du me dhënë votë as “pro” e as “kundër” po du me “abstenuar”, arsyeja është se këtë Draft-Konizë duhet me analizuar më mirë edhe në mbledhjen e Kuvendit, pataj do të dalim me qëndrim konkret, do ti analizojmë edhe projektet, dhe pastaj do ta shohim a jemi për votën “pro” apo “kundër” edhe propozimet do të jenë në Kuvend, për arsye se materiali është ardhur me vonesë edhe nuk kemi pasur kohë me i analizuar mire kërkesat e debateve publike, dhe sa kan mundur me u inkorporuar në këtë Draft-Kornizë.

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Profes Muhamet i dëshirojmë mirëseardhje në këtë komitet, po ashtu Shqiprim, sa i përket KAB-it desha me thënë që fokusi më i madh i joni edhe i qytetarëve është te projektet kapitale. Një pyetje për drejtorin sipas diskutimeve publike që janë mbajtur dhe kërkesave që kanë rrjedhur deri tani, sa prej kërkesave kanë mundur me u futë në këtë Draft-Kornizë, dhe a keni ndonjë listë total të kërkesave sa kanë ardhur, a keni arrit me i futë në këtë Kornizë për arsye se Buxheti është i limituar, a keni ndonjë statistikë dhe a keni ndonjë listë të atyre kërkesave që nuk keni mundur me i futë në këtë Draft-Kornizë, të pakten me na tregu si numra, sa kanë qenë kërkesat.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sa i përket dëgjimeve buxhetore, kena pas kërkesa edhe tjera, edhe kërkesa te subvencionet, kërkesa edhe te mallrat dhe shërbimet te mirëmbajtja e varrezave, sa i përket kërkesave, Drejtorria e Urbanizmit i ka pasur gjitha kërkesat edhe atje janë filtruar, cilat janë në buxhet të këtij viti, e cilat janë për vitin tjetër, mirëpo ata i kan filtruar, cilat janë të këtij viti edhe cilat janë më prioritare për vitin e ardhshëm 2026.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit pasi që është hera e parë pjesmarrja ime në këtë Komitet. Sa i përket draftit e falënderoj drejtorin për informatën, mirëpo edhe unë e kamë marrë materialin pak me vonesë, dhe nuk e kam analizuar, kamë marrë pjesë në debatin publik në fshatin Petrovë. Unë kamë paraqitur disa kërkesa të lagjes time mirëpo siç e pashë këtu nuk janë të përfshime, kështu që edhe kur vjen puna te vota unë kësaj radhe do të “abstenoj” ku do ti analizoj edhe këto dy tri dit sa kanë mbetur deri në mbledhjen e Kuvendit, do ta marrë vendimin për përkrahje apo për mos përkrahje.

Te dëgjimet publike pasi që për veç një ditë ose dy nuk kamë marrë pjesë për arsye shëndetësore. Tjerat gjitha kërkesat e tha edhe Lumi janë futur në Draft-Korniz, por ne në secilin dëgjim publik ju kemi bërë me dije që kanë kërkuar diçka që kanë kërkuar edhe në vitin e kaluar e realisht u kanë në Buxhet, edhe ato kërkesa nuk munden me u futur prap në buxhet, sepse ajo është në buxhetin e vitit 2025. Disa kërkesa tjera ne i kemi për shembull te asfaltimi rrugëve ne i kemi disa kontrata aktive që i kemi marrë nga niveli qendror të cilat nuk kemi pasur nevojë me i futur ne buxhet për vitin 2026, spese në fund të vitit përfundojnë. Është reale që ka pasur kërkesa, e di që njëra nga fshatrat

nëse nuk gaboj në fshatin Godanc janë kanë dikund 35 kërkesa, dhe 35 këreksa me një fshat është e pa mundur me i futur në Buxhet. Ka pas fshatra që i kanë pasur 5-6 kërkesa gjithëpërfshirëse e kanë përfshirë komplet fshatin, ka pasur psh. rast në dëgjimet publike që një person ka folur për krejt fshatin, ata paraprakisht e kanë mbajtur një mbledhje edhe ata i kanë shënuar cilat janë kërkesat prioritare për fshatin, edhe një person e ka marrë fjalën edhe ka fol për komplet fshatin si psh. Lumi me fol për komplet fshatin Pjetërshticë. Kanë thënë na kemi ardhur në diskutim public, kemi diskutuar paraprakisht si fshat, dhe këto janë kërkesat tona, kjo ka ndodhur në disa fshatra. Është diçka e mirë që këtë vit ka qenë një numër më i madh i qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime publike për buxhet, edhe shumë mirë që kanë bërë kërkesa, sepse jo na si Kuvend e si qeverisje mundemi me i ditur të gjitha kërkesat e qytetarëve. Buxheti ndërtohet shumë më mirë kur merren kërkesat direkte prej qytetarëve. Drejtoria e Urbanizmit dhe Zyra e Kryetarit e dinë cilat projekte janë në vitin 2025 dhe cilat janë të zhvilluara dhe nuk e kanë pa të arsyeshme me i futur në këtë buxhet për 2026 sepse ato përfundojnë këtë vit, o janë në Kornizën e kalueme o janë në Buxhetin e nivelit qëndror, që thashë janë disa kontrata aktive.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Shumica e projekteve janë që kanë me u kry në vitin 2026, për veç disa rrugëve të arave që thamë në Godanc i kanë kërkuar. Përnime në Godanc ka pasur shumë kërkesa.

z.Lumni Amrush: Tash edhe Godancin e keni halitur pak më shumë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ki drejt këtu Lum.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Kjo është Draft-Koniza, këto janë projekte për të gjithë anëtarët e komitetit dhe gjithë qytetarët, dera është qel nëse keni mundësi me porpozuar ndonjë projekt që mendoni që ja vlen dhe është nevoj imediate. Kena hapësirë për me futur.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Na e tha edhe drejtori na e analizojmë Draftin dhe të gjitha kërkesat që i kanë asambleistët. Mundet me na ik edhe ndonjë kërkesë edhe gjatë dëgjimeve publike, sidomos në Petrovë u kanë njëfar zhurme për shkak të punimeve që janë kanë duke u bërë në aneksin e ri të shkollës.

z.Lumni Amrush: Desha me ditë për një kërkesë që ka qenë më herët për te Kulla e Lirisë, diçka për një muri mbrojtës përmes Urbanizmit ka shkuar kërkesa.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: U kanë si kërkesë edhe gjatë dëgjimit publik edhe besoj që është futur si kërkesë. Pra nëse nuk është në këtë Konizë ajo do të kryhet sivjet. Është diçka e mirë që ç' do ditë e më shumë kërkesat po shkojnë duke u bërë më të vogla, ka me ardhur koha që kanë me kërkuar veç për mirëmbajtje, për veç nëse bëhet një rrugë e re apo ndonjë shtëpi e re.

z.Muhamet Ademaj: Një pyetje drejtorit, na e kemi votuar ku e kamë një rast konkret për buxhetin e vitit 2023, aty ka qenë e paraparë në lagjen time me u shtruar një rrugë asfalt, ka nja 200-300 metra, mirëpo unë besoj që nuk është realizuar dhe është bartur në pjesën tjetër, pra është mirë që nëse këto projekte, nëse i votojmë me i realizuar. Na e kemi edhe rastin e trotuarit prej Mollopolcit në Shtime. dhe u banën gati 4 vite, edhe ai projekt nuk realizohet, kështu që është mirë që këto projekte tona çka ti votojmë edhe me u realizuar.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Na e dimë që kontrata kolektive, shumë projekte i ka ataku, na jemi njerëz, mundemi me gabuar por nëse shkruan për Reçak, nuk mundet me shkuar në një fshat tjetër sepse kur hynë te certifikuesi është vështirë me kaluar.

z.Muhamet Ademaj: Aty shkruan aneksi rrugës "Kruja" që ai aneks i rrugës është shkuar me një lagje tjetër është shtruar një rrugë tjetër, kur ta votoj është mirë me ditë çka po votojmë dhe ai projekt duhet me u relizuar, dhe me ardhë qaty ku e kemi votuar, jo jo propozimi jem ekziston edhe mundeni me shku me shikuar te arkiva. Drejtori më është arsyetuar se i ka marrë kontrata kolektive dhe i ka prek disa projekte.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Drejtori po thot kontrata kolektive i ka prekur disa projekte, nëse kontrata kolektive e ka prekur një projekt ai nuk mundet me u realizuar, zyra e financave duhet me bërë një analizë edhe me i argumentuar njerëzve në Kuvend, se këto projekte janë për vitin 2023, 2024, 2025, dhe i ka marrë përmbaruesi nga kontrata kolektive, edhe atëherë jena në rregull, e jo veç me thënë i ka marrë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Unë po them që, tani mundeni me ardhur pas takimit te zyrja ime edhe me i pa cilat projekte i ka prekur kontrata kolektive, unë nuk e besoj në Petrovë që po thu prof.

që ka shku dikund tjetër projekti, unë të garantoj 99 për qind që nuk ka shkuar dikund tjetër se s'ka mundësi. Nëse ka shkruar rruga "Kruja" me letra, qatje ka me shkuar ajo rrugë ate po ta grantoj.

z.Muhamet Ademaj: Unë e kam pyetur edhe këtë drejtoreshen Shqipe Rexhaj që ka qenë te Urbanizmi më herët nuk ka mundur me më kthyer përgjigje.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Hajde pas takimit prof. edhe i shiqojmë krejt senet.

znj.Adelina Beqaj: Sa i përket këtyre kërkesave për asfaltime, kena parë që me të vërtet kohëve të fundit është shtruar asfalt shumë, ndoshta pa ndonjë kriter të caktuar, më mirë me thënë politikisht të prekur. Po pajtohna me profen që është planifikuar, nuk e di drejtor në 2021 është planifikuar ka filluar me i marrë mjetet prej 2024 e këndej me sa kam njohuri, me të vërtet gjenë vend për diskutim, ku arsyetoheni që i ka marrë kontrata kolektive a është e mujshme që gjitha mjetet e një projekti me i marrë kontrata kolektive.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Po ta merr komplet projektin gjitha mjetet, ta prish projektin krejt.

znj.Adelina Beqaj: A ka mundësi drejtor ndoshta nuk është krejt përgjegjshi e jotja por a ka mundësi me bërë një listë të secilit projekt që e ka prekur kontrata kolektive në mënyr që ne si anëtar të Kuvendit ta kena një pasqyrë qysh me u adresuar, psh. ky profa e ka kërkesën direkte, filan rruga nuk është përfunduar por është shtruar rruga tjetër, ky është tu lyp argument pse nuk është rregullu, ndoshta ka edhe shumë rrugë tjera, dhe dyshoj shumë që i keni marrë dhe i keni quar dikah tjetër. Në Petrovë nuk është që edhe shumë keni shtruar rrugë, për këtë arsye po kërkoj një pasqyrë që me pas më të qartë për mbledhjen e Kuvendit, se ku kanë shkuar mjetet, ku i kanë marrë përmbaruesit e kështu me radhë. E di që nuk është përgjegjësi e jotja por me bashkëpunimin tënd me drejtorët tjerë besoj që mundesh me pas një pasqyrë të till.

z.Lumni Amrushi: Sipas profes është votuar aneksi i rrugës "Kruja" dhe është shtruar një enkes tjetër i një rruge tjetër qatë afër, nuk ka të bëjë me kontratën kolektive, ky është devijim i projektit i cili ka qenë i specifikuar, edhe një diçka që një anëtar i juaji i jep shumë pompozitet, që na po i specifikojmë projektet, kjo është ai shqetësimi më i madhë prej secilit prej neve, profa është këtu po çka ndodh me një qytetarë të thjeshtë kur e banë një kërkesë dhe ju e shtini në Buxhet dhe vitin tjetër nuk realizohet qajo kërkesë, apo shkon pak më andej, apo pak më këndej, pasi që po lypet në aspektin politik, pra nuk mundet me gjeneralizuar secilin projekt me këtë kontratën kolektive. Një shqetësim më i madhë është kjo çështja e specifikimit, kurë një aneks i rrugës shkon të njejtën rrugë apat që thojna na hahet diqysh, qyshë thojna na popullorqe, por nëse shkon me një aneks të rrugës tjetër. Ose shef emra të rrugëve që hiq nuk ekzistojnë psh. te ne në Pjetërshticë shkruan te projekti rruga, por su ba ajo rrugë kurrë, tash e pash një emër tjetër, është një diçka që është shqetësuese, "Kadri Musolli" rrugë nuk ka në Pjetërshticë, mundet me kanë rruga e Kadries, ose aneks i rrugës "Musolli", ama nuk mundesh me shti rrugë "Kadri Musolli".

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Kërkesa ka ardhur qashtu, nëse ka probleme në përshkrim të rrugëve ne prap mundemi me i përmirësuar.

z.Lumni Amrushi: Po ti duhesh me dit se e ki Urbanizmin qatë, i ke krejt emërtimet e rrugëve qatë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Gabimet teknike përmirsohen, por nëse shkruan segmentet e rrugëve "Abedin Murseli", aty mund të përfshihen secili segment i kësaj rruge, por nëse nuk shkruhet ashtu unë për ate po e ftoj profen hajde në zyre edhe i gjejmë secilën kërkesë.

z.Muhamet Ademaj: Kur ta thamë unë 100 për qind e ki të sakt, edhe s'kamë pas me fol hiq por kur pe shof që janë tu u realizuar rrugët tjera, tash po duhet edhe unë me thanë qat propozim që e kam pasur.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Nuk po du me ta hjekë dyshimin, por e din që auditorët e jashtëm minimumi 10 rrugë i kërkojnë për shikim, edhe nëse e gjenë një këso gabimi ka me shkruar në raport, as vitin e kaluar nuk ka pasur gjetje të ndrrimit të destinimit të projektit.

z.Lumni Amrushi: Ama mundet me pas fatin kjo rrugë që mos me marrë hiq auditorët.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Nuk po thamë që i ka marrë krejt por sivjet ishin mbi 20, kemi dalur mirë nuk ka hasur auditori në këso ndrrimi të destinimit, nëse në një kishte hasur e kishte rritur interesimin dhe pastaj ai kishte marrë mostra edhe më shumë. Sa i përket asaj që tha Adelina në ç'do moment e njoftojmë drejtorin për secilin projekt, që është prekur dhe në momentet kur kemi hapsir me korigjuar e kryejmë.

znj.Adelina Beqaj: Çyshtë është e mundur drejtor me dalë psh. me i ba matjet me një rrugë dhe mos me ndodhë kurrë ai realizim i asaj rruge? Po pyes për rast konkret nuk po du me dhënë as emra as kurgja, kjo po më duket pak shqetësuese edhe për banorët e lagjes për njerëzit që ju hyjnë në shtëpi ashtu pa pyet as kurgja edhe thirrën në telefon, çka është kjo kompani, sepse nuk po e dina, është e pa logjikshme.

z.Lumni Amrushi: Lirisht thuaj që sivjet ka me u shtruar ajo rrugë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Atëherë pjesën tjetër e vazhdojmë edhe në Kuvend, është mirë me i scharuar këto drejtoritë e Financave por edhe drejtoria e Urbanizmit dhe e Prokurimit se cilat projekte i ka marrë përmbaruesi, me ua hjekë dilemat anëtarëve të Kuvendit. Ne po e hudhim në votim Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe i rekomandojmë drejtorive që nëse ka gabime teknike te rrugët të përmirësohen nesër para se të vijë mbledhja e Kuvendit, deri në Shtator ka kohë.

znj.Adelina Beqaj: Intersant qysh e interpretoni, del Drafti thuani e keni në Gusht, del diskutimi thuani e kemi në Shtator, dmth. gjithmonë e arsyetoni mbi bazën e asaj, a kur po del finalizimi i Buxhetit thuani e kemi pasur në diskutim publik.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Adelina ju kamë thënë edhe atëherë edhe tani deren qelë e keni për çka do që keni, hajde nëse ke ndonjë projekt që ka më përparësi e që duhet me hy në dokument kemi me e rregulluar.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” (Duke përdor Kryesuesi votën e dyfisht sipas nenit 48.1 Ligjit Nr.03/L-040 të LVL-së) me 0 vota “Kundër” dhe me 4 vota “Abstenim”, vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoj në ora 11:08h.

Procesmbajtësi
Shqiprim Hyseni



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

